

VLERËSIMI I NJOHURISË, QËNDRIMEVE, PRAKTIKAVE
DHE NEVOJAVE TË DEPUTETËVE NË PARLAMENTIN E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË LIDHUR
**ME TË DREJTAT E LGBTI NJERËZVE DHE
MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI**

BOTIM I SHKURTUAR
2018

Ky dokument i shkurtuar i "Vlerësimi i njohurisë, qëndrimeve, praktikave dhe nevojave të deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë lidhur me të drejtat e njeriut të LGBTI njerëzve dhe mbrojtja nga diskriminimi". Versionin original të dokumentit mund ta gjeni te www.hera.org.mk

Botues:

HERA - Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim

Autorë:

Natasha Boshkova
Dragana Drndarevska

Redaktorë:

Jovana Ananievská
Elena Petrovska

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Gramoz Shabani

Dizajni dhe radhitja e brendshme:

Jana Misheva

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.726-055.3

BOSHKOVA, Natasha

Vlerësimi i njohurisë, qëndrimeve, praktikave dhe nevojave të deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë lidhur me të drejtat e njeriut të LGBTI njerëzve dhe mbrojtja nga diskriminimi / [autorë Natasha Boshkova Dragana Drndarevska]. - botim i shkurtuar. - Shkup : Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim H.E.R.A, 2018. - 12 стр. : табели ; 30 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4598-93-0

1. Drndarevska, Dragana [автор]

а) Лица со различна сексуална ориентација - Заштита од дискриминација

COBISS.MK-ID 106196234

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Metodologjia	5
3. Gjetjet kryesore	6
3.1. Gjetjet kryesore nga desk analiza e ligjeve, akteve nënligjore, programeve të partive politike dhe iniciativave të organizatave qytetare	6
3.2. Gjetjet kryesore nga intervistat me deputetët	8
3.2.1. Njohuritë dhe qëndrimet e deputetëve për çështjet lidhur me të drejtat e LGBTI njerëzve	8
3.2.2. Praktikat e deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, jo diskriminimit dhe të drejtat e LGBTI njerëzve	12
3.2.3. Nevojat e deputetëve në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë për përmirësimin e rolit të tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, jo diskriminimi dhe të drejtat e LGBTI njerëzve	14
4. Përfundim	15
Tabela 1. Numri i deputetëve të partive politike të cilët morën pjesë në intervistë	5
Tabela 2. Mbështetja e iniciativave të organizatave qytetare lidhur me të drejtat e LGBTI njerëzve dhe kërkesat e lindhura në periudhën parazgjedhore nga ana e partive politike parlamentare	7
Tabela 3. Pasqyra e përgjigjeve të deputetëve lidhur me faktet moderne dhe të pranuara shkencërisht dhe informatat për homoseksualitetin dhe trans gjininë	9
Tabela 4. Përgjigjet e deputetëve për mbështetjen ndaj ligjeve të veçanta dhe politikave për avancimin e të drejtave të LGBTI	13

1. HYRJE

Mosrespektimi i të drejtave të LGBTI njerëzve, veçanërisht refuzimi të miratohen ligje dhe politika të cilat do ta mbrojnë këtë grup nga dhuna, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, ishte përcaktuar si problem nga ana e organizatave qytetare, trupave regional dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe Komisionin Evropian. Raportet për avancimin e Maqedonisë në procesin e euro integrimeve në vazhdimësi tregojnë për nevojën nga përmirësimi i kornizës ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përmirësimi i praktikës në hulumtimin e gjetjeve për ekzistimin e rasteve të diskriminimit dhe dhunës mbi LGBTI njerëzit.¹

Parlamenti i Republikës së Maqedonisë si organ legjislativ është kompetent të miratojë ligje të reja dhe ti ndryshojë dhe plotësojë ligjet ekzistuese, e mbështetja nga shumica e deputetëve është e domosdoshme për përmirësimin e kornizës ligjore për avancimin e të drejtave të LGBTI njerëzve. Rezultatet nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016 i rritën pritet e LGBTI aktivistëve, por edhe të opinionit ndërkombëtar lidhur me krijimin e vullnetit politik për miratimin e ligjeve dhe politikave me të cilat Republika e Maqedonisë do t'i plotësojë obligimet e ndërmarra dhe do t'i marre parasysh kërkesat e vazhdueshme për avancimin e të drejtave të LGBTI.

Me qëllim të sigurimit të dhënavë për njohurinë, qëndrimet, kapacitetet, praktikat dhe nevojat e deputetëve në përbërjen aktuale në Parlament, Asociacioni për edukimin shëndetësor dhe hulumtim HERA, në partneritet me Koalicionin Margini, e zbatoi Vlerësimi i njohurisë, qëndrimeve, praktikave dhe nevojave të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë lidhur me të drejtat e njeriut të LGBTI njerëzve dhe mbrojtja nga diskriminimi.

¹ Komisioni Evropian. Raport për avancimin e Maqedonisë për vitin 2015, Bruksel 2015.

2. METODOLOGJIA

Për nevojat e këtij vlerësimi, në periudhën prej korrikut deri në tetor 2017, u realizua hulumtimi përmes intervistave gjysmë të strukturuara me deputetët e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë. Që të sigurohet kontroll në kontekstin juridik dhe politik në të cilin punojnë deputetët, janë bërë desk analiza të programeve të partive politike nga zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, analiza e përpjekjeve të partive politike parlamentare për përmirësimin e ligjeve dhe politikave për mbrojtje të drejtave të LGBTI, janë shprehur përmes nënshkrimit të deklaratave dhe iniciativave të ngjashme të organizatave qytetare, analiza e ligjeve dhe akteve nënligjore të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë dhe analiza e iniciativave të mëparshme në Parlament lidhur me të drejtat e LGBTI njerëzve.

Fillimi ishte caktuar ekzemplari i cili i përgjigjet përfaqësimit procentual të partive politike në Parlament, përkatësia etnike dhe gjinia. Ky ekzemplar nuk u arrit pasi që një pjesë e madhe e deputetëve nga partia politike VMRO-DPMNE² refuzuan të marrin pjesë në intervistat dhe nuk iu përgjigjën ftesave dhe thirrjeve telefonike, ose vazhdimisht e anulonin pjesëmarrjen në intervista. Një deputet i Partisë Demokratike të Turqve të Maqedonisë refuzoi të marre pjesë në intervistë, për shkak se qëndrimet e partisë së tij politike lidhur me këtë çështje janë kozervative dhe nuk e konsideronte se duhet të marre pjesë. Për shkak të kësaj gjendje, me hulumtimin nuk arritëm të fitojmë të dhëna relevante për qëndrimet, njojuritë dhe praktikat e deputetëve nga të gjitha partitë politike parlamentare, që paraqet kryesisht kufizim të vlerësimit.

Në intervistë morën pjesë gjithsej 13 deputetë, përfaqësues të këtyre partive politike:

Tabela1. Numri i deputetëve të partive politike të cilët morën pjesë në intervistë

Partia politike	Femra	Meshkuj	Gjithsej
VMRO-DPMNE	1	0	1
PSM	0	1	1
BESA	0	1	1
Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë	0	0	0
Gjithsej deputetë nga opozita	1	2	3
LSDM	0	3	3
Aleanca për shqiptarët	0	1	1
BDI	1	1	2
Deputetë të pavarur	1	1	2
PLD	1	0	1
DOM	1	0	1
Gjithsej deputetë nga pozita	4	6	10
Gjithsej	5	8	13

2 Në intervistat mori pjesë vetëm një deputete nga VMRO-DPMNE.

3. GJETJET KRYESORE

3.1. GJETJET KRYESORE NGA DESK ANALIZA E LIGJEVE, AKTEVE NËNLIGJORE, PROGRAMEVE TË PARTIVE POLITIKE DHE INICIATIVAVE TË ORGANIZATAVE QYTETARE

1. Deputetët në Parlament, në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, kanë **mundësi të gjera të vendosura për veprim në drejtim të avancimit të drejtave të LGBTI njerëzve**, ndërsa vendojja administrativo-teknike e organit legjislativ jep mundësi faktike për operacionalizimin e dispozitave ligjore dhe të rregullores. Përveç kompetencës legjislatieve deputetët kanë edhe mekanizma tjera si të ndikojnë drejt avancimit të drejtave të LGBTI, siç janë **pyetjet e deputetëve, diskutimet mbikëqyrëse, puna e komisioneve parlamentare, themelimi i komisioneve anketuese për çështjet me interes publik, themelimi i grupeve punuese, inkuadrimi i ekspertëve në punë, zbatimi i realizimeve dhe analizave**, por edhe mundësi për inkuadrimin e organizatave qytetare dhe qytetarët në punën e Parlamentit. Ekziston edhe mundësia për organizimin joformal të deputetëve në grupe, për shkak të unifikimit rrëth çështjeve të caktuara në interes të drejtave të qytetarëve.

2. Të drejtat e **LGBTI njerëzve pothuaj mungojnë nga programet e shkruara të partive politike parlamentare**, me përjashtim të DOM, në Programin e të cilës ka kapitull të veçantë kushtuar LGBTI njerëzve. Në Programin e PLD diskriminimi në bazë të orientimit seksual njihet në mënyrë të theksuar. Në Programin e LSDM-së, LGBTI njerëzit përmenden vetëm në kontekst të bashkësisë, e cila është viktimë e gjuhës së motivuar nga urrejtja dhe dhuna, derisa te VMRO-DPMNE mungon çfarëdo njohje e LGBTI njerëzve si bashkësi prej interesit. BDI angazhohet për barazi gjinore, por në tekstin e njëjtë e potencon rëndësinë e ruajtjes së vlerave familjare dhe rolin e gruas në familje, që në kundërshtim me konceptin paraprakisht të promovuar të barazisë gjinore. Në Programin e BESA nuk njihen LGBTI njerëzit, por për të drejtat e njeriut flitet vetëm nga aspekti i afirmimit të çështjeve etnike të shqiptarëve. Edhe pse përfundim të ngjashëm mund të sjellim edhe për Programin e Aleancës për shqiptarët, megjithatë kjo përmban angazhimë të qarta për respektimin e të drejtave të njeriut të gjithë qytetarëve në pajtim me standartet evropiane.

3. Shumica e **partive politike të cilat e përbëjnë shumicën parlamentare në periudhën parazgjedhore dhanë mbështetje të iniciativave të organizatave qytetare** përmes nënshkrimit të deklaratave, kërkesave dhe dokumenteve të ngjashme për avancimin të drejtave të LGBTI njerëzve dhe për çështje të ndërlidhura. **LSDM, DOM dhe PLD i mbështetën kërkesat e drejtpërdrejta për avancimin e të drejtave të LGBTI**, si ndryshime ligjore dhe masa për mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna, avancimi i të drejtave, avancimi i të drejtave të trans-njerëzve dhe ngjashëm. Prej partive politike nga shumica parlamentare, **ASH** është partia e vetme e cila e mbështet iniciativën për qëndrueshmëri të HIV programit dhe avancimin e përbajtjeve mësimore për shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, derisa BDI dha mbështetje vetëm për ratifikimin e Konventës së Stambollit. **VMRO-DPMNE nuk u nënshkrua në asnjë iniciativë të organizatave qytetare, ndërsa BESA e mbështeti vetëm kërkesën për ratifikimin e Konventës së Stambollit. (Tabela 2)**

Tabela 2. Mbështetja e iniciativave të organizatave qytetare lidhur me të drejtat e LGBTI njerëzve dhe kërkesat e lidhura në periudhën parazgjedhore nga ana e partive politike parlamentare

	LSDM	VMRO-DPMNE	BDI	BESA	DOM	PLD	ASH	PAE	PNSD	GROM
LGBTI njerëzit duhet të kenë të drejta të barabarta qytetare si të gjithë qytetarët tjera	✓				✓					
Vendosja e përbajtjeve lidhur me LGBTI në shkollat e mesme	✓				✓					
Gjykimi publik i gjuhës së urrejtjes në bazë të OSIGJ	✓				✓					
Vendosja e OSIGJ në Ligjin për diskriminimin	✓				✓					
Ndryshimet ligjore me të cilat dëtih familjet me çifte të gjinisë së njëjtë ³	✓				✓					
Njohja juridike e gjinisë në dokumentet personale ^{4,5}	✓				✓					
Mbulimi i shpenzimeve financiare nga FSSHM për vërtetimin mjekësor të gjinisë	✓				✓					
Avancimi i programeve mësimore për shëndetin dhe të drejtat se seksuale dhe riprodhuese	✓				✓	✓	✓	✓		
Përgjigje nationale e qëndrueshme ndaj HIV	✓				✓	✓	✓	✓		
Iniciativa e Fondacionit "Fridriht Ebert", "Obligimi tani! Për ditën pastaj!"	✓				✓	✓	✓	✓		
Ndryshime të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë	✓				✓	✓	✓	✓		
Pengimi dhe mbrojtja nga format e ndryshme të dhunë mbi gratë dhe ratifikimi i Konventës së Stambollit	✓		✓	✓	✓	✓	✓	✓		

3 Në pyetësorin e organizatës Fronti subverziv, LSDM u përgjigj se nuk ka mendim lidhur me këtë çështje, por e mbështeti me nënshkrimin e iniciativës së Fondacionit "Fridriht Ebert", "Obligimi tani! Për ditën pastaj!"

4 Në pyetësorin e organizatës Fronti subverziv, PLD u përgjigj se nuk ka mendim për këtë çështje, por e mbështet me nënshkrimin e iniciativës së Fondacionit "Fridriht Ebert", "Obligimi tani! Për ditën pastaj!"

5 Kërkesat në dokument përfshinë: mbrojtja ligjore dhe faktike nga dhuna, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes së LGBTI në Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Kodi penal, miratimi i Strategjisë nacionale kundër homofobisë dhe transfobisë, rregullorja për njohjen juridike të gjinisë, ndryshimet në Ligjin për familjen, mbulimi i shpenzimeve për vërtetimin mjekësor të gjinisë nga FSSHM.

3.2. GJETJET KRYESORE NGA INTERVISTAT ME DEPUTETËT T

3.2.1. NJOHURITË DHE QËNDRIMET E DEPUTETËVE PËR ÇËSHTJET LIDHUR ME TË DREJTAT E LGBTI NJERËZVE

1. Deputetët e intervistuar kanë **njohuri të pjesshme të kornizës ligjore për mbrojtje nga diskriminimi i LGBTI njërëzve**. Deputetët e njohin Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, por nuk kanë informata konkrete që ai i rregullon dhe cilat trupa janë kompetente. Një pjesë e deputetëve e njohin problemin me funksionalitetin dhe pavarësinë e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi.

Komisioni si trup është në rregull, por nuk jemi të kënaqur nga mënyra se si ai funksionon dhe cilat janë përfitimet, rezultatet nga ky funksionim. Me siguri duhet të ndërtohen edhe kapacitetet e anëtarëve të komisionit dhe të kenë më shumë mjete financiare në këtë pikëpamje, por sipas meje është i rëndësishëm vullneti politik i atyre të cilët e punojnë këtë.⁶

2. Të ndryshme janë njohuritë e deputetëve për gjuhën e urrejtjes dhe nëse dhe si është rregulluar kjo çështje në Maqedoni. **Vetëm katër nga deputetët e anketuar (31%) në mënyrë eksplikite u përgjigjën se gjuha e urrejtjes nuk sanksionohet, ndërsa tre (23%) prej tyre e kanë cekur Kodin penal** si dokument i cili e rregullon këtë çështje, derisa njëri nuk e di saktësisht se cili ligj e rregullon këtë çështje. Krahas mospasjes së kornizës së qartë, deputetët e intervistuar si problem e identifikojnë edhe praktikën e mos dënimit të gjuhës së urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes do të duhej të sanksionohet, por unë mendoj se diçka e tillë nuk praktikohet në Maqedoni.⁷

3. Deputetët e intervistuar treguan se **njohuri të mëdha për ligjet me të cilat dënohet dhuna e motivuar nga urrejtja**. Përafërsisht të gjithë (92%) thanë se dhuna nga urrejtja dënohet. I ndryshëm është niveli i njohurisë për ligjet e sakta të cilat e rregullojnë dhunën nga urrejtja, por me sqarimin e përgjigjeve rreth kësaj pyetje deputetët e identifikuani problemin në implementimin e ligjeve.

4. Kur fjala është për nivelin e njohjes së **të dhënavë/fakteve konkrete të cilat kanë të bëjnë me LGBTI njërëzit**, ndërsa të cilat janë në lidhje të ngushtë edhe me qëndrimet e deputetëve të intervistuar rreth LGBTI njërëzve, ata **kanë njohuri adekuate**. Pjesa më e madhe e deputetëve të intervistuar (69%) pajtohen se homoseksualiteti nuk është sëmundje. Një nga deputetët e intervistuar theksoi se nuk është i sigurt, ndërsa deputetët tjerë (23%) thonë qartë se homoseksualitetin e llogarisin për sëmundje, ku një nga të intervistuarit shtoi se mund të përdoret termi “dispozitë e lindur”, pasi që “sëmundje” është term shumë i ashpër.⁸

Te pyetjet që kanë të bëjnë me HIV, orientimi seksual i fëmijëve të cilët kanë prindër të gjinisë

6 Intervista nr. 4, deputet nga DOM.

7 Intervista nr. 6, deputet nga BDI.

8 Intervista nr. 12, deputet i ASH.

së njëjtë dhe identiteti gjinor i njerëzve, vërehen njohuri më të vogla ose paragjykime më të mëdha. Rezultatet e këtilla te disa nga deputetët ka të bëjë me informatat të cilat i emitojnë mediat ose mungesa prej tyre, ndërsa te të tjerët paragjykimet personale lidhur me LGBTI njerëzit.

(Tabela 3)

Për shembull, një nga deputetët e ndau qëndrimin e tij kritik lidhur me atë që btohet në media për HIV:

Nuk kam të dhëna të sakta statistikore, kam dëgjuar se ky është një nga shkaqet kryesore i këtyre sëmundjeve. Që nuk do të thotë se kjo është e saktë, më shumë heteroseksual përcjellin. Të ishte e saktë, do të kemi vetëm meshkuj të sëmurë.⁹

Tabela3. Pasqyra e përgjigjeve të deputetëve lidhur me faktet moderne dhe të pranuara shkencërisht dhe informatat për homoseksualitetin dhe trans gjininë

	Saktë	Jo e saktë	Jo preciz
Sipas pikëpamjeve të shkencës moderne, homoseksualiteti është sëmundje.	1	9	3
Homoseksualiteti mund të shërohet me terapi adekuate psikiatrike dhe hormonale.	4	8	1
Maqedonia është mes vendeve të Evropës ku ka përqindje më të vogël të gej-meshkujve të cilët në mënyrë të hapur jetojnë me statusin e tyre.	12	1	
Në numrin më të madh të rasteve jeta nën presion të mos tregohet identiteti personal gjinor dhe orientimi seksual mund të jetë e dëmshme për shëndetin e përgjithshëm të individëve.	13		
Përvoja nga dashuria është e ngjashme për të gjithë njerëzit, pa dallim të orientimit seksual.	12	1	
Mënyra dominuese e transmetimit të virusit HIV në botë akoma është marrëdhënia seksuale, ndërsa në vend të parë është marrëdhënia seksuale mes meshkujve që kanë seks me meshkuj.	7	4	2
Homoseksualët të cilët jetojnë me partner/e të gjinisë së njëjtë janë po aq të lumtur sa edhe femrat dhe meshkujt në martesën heteroseksuale.	12	1	
Më e sigurt është se fëmijët të cilët jetojnë me prindër të gjinisë së njëjtë edhe vetë të bëhen homoseksual.	4	7	2
Seksualiteti është punë private dhe homoseksualët nuk ka nevojë për këtë të flasin në opinion.	4	11	
Homoseksualiteti dhe trans gjinia janë fenomene perëndimore, jo karakteristike për Maqedoninë.	2	11	
Njerëzit lindin ose si meshkuj ose si femra dhe nga kjo varet edhe nëse do të identifikohen si gjini mashkulllore ose femërore.	3	7	3

⁹ Intervista nr. 12, deputet i ASH.

5. Të gjithë deputetët, përveç një deputeti të Partisë Socialiste të Maqedonisë, i njojin LGBTI njerëzit si viktima të diskriminimit dhe shkelja e të drejtave.

Pyetjen e keni me dy kuptime, pasi që unë nuk mund të përgjigjem në mënyrë adekuate, do të thotë një është tradita, tjetër është vendosja shoqërore, dhe ata nuk përshtaten në shoqëri dhe nuk i pranon shoqëria. Prandaj edhe pasojat janë të tilla.¹⁰

Pjesa më e madhe e deputetëve **mendojnë se LGBTI njerëzit nuk gëzojnë mbrojtje adekuate ligjore (92%) dhe se institucionet sillen në mënyrë të pavolitshme ndaj tyre (77%)**, edhe pse shumica nuk janë njoftuar me ligjet vendore, të cilat përbajnë ndalesë për diskriminimin në bazë të orientimit seksual, edhe pse në Maqedoni ka tetë ligje të tilla.

6. Njohuri më të dobët deputetët treguan për gjendjen e njerëzve trans gjinor dhe mundësia që në mënyrë mjekësore dhe juridike t'u njihet gjinia. Informatat me të cilat disponojnë, janë marrë nga mediat, të cilat raportojnë për ndryshim të gjinisë, të realizuar në një nga klinikat private në Maqedoni, por nuk kanë informata si dhe nëse kjo çështje do të rregullohet në mënyrë sistemore. Afërsisht **gjysma nga deputetët e intervistuar nuk janë njoftuar me sfidat me të cilat ballafaqohen njerëzit trans gjinor**. Vetëm një deputet e përmendi problemin me njohjen juridike të gjinisë në dokumentet e njerëzve trans gjinor.

Nuk mund t'i ndryshojnë të dhënrat në dokumente. Kishim rast në gjimnazin XX kur nxënësi kishte problem ta marre dëftesën me emër dhe mbiemër të ndryshuar. Për shkak të ligjit të paqartë, shkolla kishte problem me zgjidhjen e kësaj çështje.¹¹

7. Shumica (85 %) e deputetëve të intervistuar mendojnë, se në Maqedoni, qytetarët që më së shumti janë të ekspozuar nga diskriminimi janë romët dhe se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike është më i përfaqësuar. **Më shumë se gjysma e deputetëve (54 %), krahas të tjerëve, i ndanë LGBTI njerëzit si një nga qytetarët e diskriminuar**, derisa tre i përmendën njerëzit me aftësi të kufizuara.


8. Distanca sociale ndaj LGBTI njerëzit

Pjesa më e madhe e deputetëve të intervistuar treguan **nivel të ulët të distancës sociale ndaj njerëzve me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet gjinor**. Distanca sociale ndaj njerëzve trans gjinor është dukshëm më e madhe dhe kjo ndryshon varësisht nga roli i personave trans gjinor. Një deputet tregoi nivel të lartë të distancës sociale pavarësisht në cilin rol gjenden homoseksualët, ndërsa distancë dukshëm të madhe në raport me njerëzit trans gjinor, veçanërisht kur personi është në rolin e politikanit. Te një pjesë e deputetëve **distanca rritet nga e mesme në të lartë kur personi me orientim të ndryshëm seksual ose identitet gjinor është në rolin e arsimtarit ose partnerit/es me ndonjë person të afërm**, derisa te një deputet distanca rritet edhe kur personi është në rolin e mjekut, politikanit dhe kryetarit të shtetit.

10 Intervista nr. 11, deputet nga LSDM.

11 Intervista nr. 13, deputet nga PLD.

Pasqyra skematike 1. Distanca sociale ndaj LGBTI



Pasqyra grafike e përgjigjes së deputetëve rreth pyetjes – sa do të pranon person me orientim seksual dhe person transgjinor në situatën e lartpërmendura. 1 - Aspak nuk do të pranonte 5 – tërësisht do të pranonte

3.2.2. PRAKTIKAT E DEPUTETËVE NË PARLAMENTIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NGA ASPEKTI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT, JO DISKRIMINIMIT DHE TË DREJTAT E LGBTI NJERËZVE

1. Një pjese më të madhe të deputetëve ky është mandati i parë, e një pjese të vogël mandati i dytë. Shumica e deputetëve nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në diskutime, ta marrin fjalën ose të parashtronjë pyetje deputetësh lidhur me LGBTI njerëzit, por pjesa më e madhe (62%) shprehën gatishmëri që ta bëjnë këtë në të ardhmen. Asnjë deputet nuk ka marrë pjesë në trajnim për të drejtat e LGBTI njerëzve, derisa gjashtë deputetë kanë pasur kontakt me LGBTI organizatat.

2. **Asnjë deputet nuk do të përmbahej nga votimi kur fjala është për LGBTI** njerëzit dhe thonë se do të votonin sipas bindjeve të tyre personale, e jo sipas instrukSIONEVE partiake. Vetëm 15% u përgjigjën në drejtim të asaj se **qëndrimet partiake janë po ashtu të rëndësishme**.

Nëse ndryshojnë qëndrimet e mia me qëndrimet e partisë politike, do të luftoj brenda partisë të paktën në këtë moment që të ndryshohen. Singersht, qëndrimi partiak që do të jetë të paktën në këtë moment të polarizuar mes dy partive, do të duhet të respektohet. Por do orvatem t'i afroj qëndrimet.¹²

3. Mbrojtja nga dhuna e gjëzon shkallën më të lartë të mbështetjes nga ana e deputetëve, ndërsa e drejta e adoptimit të fëmijëve më e ulët. Duhet të merret parasysh se në Republikën e Maqedonisë çështja për martesat e gjinisë së njëjtë dhe adoptimi i fëmijës duken atraktive dhe të largëta, e kështu edhe përgjigjet në këto pyetje në vete janë përpjekje deklarative të dhëna jashtë nga konteksti politik. **Mbrojtja nga dhuna dhe gjuha eurrejtjes gjëzon mbështetje më të gjërë nga mbrojtja nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor**. Kjo me siguri ka të bëjë me atë se ndryshimet në Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi kanë filluar, ndërsa Propozim ligji i ri, i cili e përfshinë orientimin seksual dhe identitetin gjinor deri më tani ishte lëndë edhe i debateve publike, e kështu partitë kanë pasur mundësi të sjellin vendime konkrete, të cilat së shpejti duhet edhe të zbatohen. Deputetët nga pushteti dhe deputetët nga partitë shqiptare dhe nga opozita janë mështetje për mbrojtje nga diskriminimi i LGBTI njerëzve, derisa një deputet nga VMRO-DPMNE është kundër, ndërsa një deputet tjetër nga opozita nuk ka përgjigje konkrete. (**Tabela 4**)

4. Përbajtja lidhur me çështjet për njerëzit trans gjinor është e madhe, ndërsa mbështetja e vogël. Çështja për **njojjen juridike të gjinisë** lidhur me ndryshimin e numrit amë dhe shenja për gjini në dokumentet për identifikim personal **gjëzon mbështetje të madhe (85%) nga vërtetimi mjekësor i gjinisë (62%)**, me siguri për shkak të implikimeve buxhetore. Ndaj njojjes juridike të gjinisë shihet si e drejtë juridike e qytetarëve të identifikohen ose të mos identifikohen me gjininë e caktuar me lindje dhe si e drejtë për përcaktim të tyre personal. (**Tabela 4**)

Nëse personi e kërkon këtë, pse jo. Qytetari e paguan letrën e njoftimit dhe pasaportën. Nëse mashkulli thotë: Jo, jam femër, dëshiroj që F të qëndrojë – pse jo?¹³

12 Intervista nr. 9, deputet i LSDM.

13 Intervistë nr. 8, deputet i BDI.

Tabela 4. Përgjigjet e deputetëve për mbështetjen ndaj ligjeve të veçanta dhe politikave për avancimin e të drejtave të LGBTI

Pyetje	Numri i deputetëve të cilët janë përgjigjur:			
	Do të propozonte dhe do të mbështeste	Do të mbështeste	Jo	Varet/ndoshta nuk kam qëndrim/do ta mbështesja nëse...
Vendosja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor në LPMD	6	5	1	1
Ndalimi dhe dënim i gjuhës së urrejtjes në bazë të OSIGJ	8	4		1
Ndalimi i dhunës dhe veprave nga urrejtja në bazë të OSIGJ në KP	9	4		
Vendosja e OSIGJ në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare	9	4		
Miratimi i Strategjisë nationale kundër homofbisë dhe transfobisë (propozimi nuk është nga opzionet e ofruara, pasi që propozues është MPPS)		12	1	
Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, finanziarish të mbështeten fushata dhe evenimente kulturore dhe për promovimin e të drejtave të bashkësisë LGBTI	5	4	3	1
Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë të financohen servise për mbështetje psiko-sociale të LGBTI njerëzve, viktima të dhunës (vendosja në qendrat për strehim, këshillim psiko-social, ndihmë juridike pa pagesë etj.), (propozimi nuk është nga opzionet e ofruara, pasi që propozues është MPPS)		12	1	
Politika/masa me të cilën do t'u mundësohet trans-njerëzve në Maqwedoni të bëjnë ndryshim mjekësor të gjinisë	4	4	2	3
Ligji me të cilin do t'u mundësohet trans-njerëzve në Maqedoni të bëjnë ndryshim juridik të gjinisë në dokumentet për identifikim personal	6	5	2	
A do të mbështetnit/kishit marrë pjesë në Paradën e krenarisë në Republikën e Maqedonisë	8		4	1
Ligji për partneritetet e regjistruara të gjinisë së njëjtë në Republikën e Maqedonisë	6	3	3	1
Ligji për martesat e gjinisë së njëjtë në Republikën e Maqedonisë	5	3	4	1
Ndryshime në Ligj me të cilin do t'u mundësohet çifteve me gjini të njëjtë të adoptojnë fëmijë	2		6	5

3.2.3. NEVOJAT E DEPUTETËVE NË PARLAMENTIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR PËRMIRËSIMIN E ROLIT TË TYRE NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT, JO DISKRIMINIMI DHE TË DREJTAT E LGBTI NJERËZVE

1. Deputetët numërojnë pengesa të ndryshme në punën e tyre në drejtim të avokimit për të drejtat e LGBTI njerëzve. Por një pjesë e madhe prej tyre mendojnë edhe se **nuk kanë pengesa të mëdha, por e theksojnë përmirësimin e gjendjes** dhe rritja e vullnetit politik te pushteti për ndryshim të gjendjes. Një pjesë e deputetëve si pengesa kryesore e theksuan anulimin e panevojshëm dhe “bllokimin” e dukshëm të shtëpisë ligjdhënëse nga ana e VMRO-DPMNE, që nga njëra anë shkakton pamundësi për dialog dhe debat konstruktiv. Një deputet nga pushteti theksoi se si pengesë e sheh veprimin partiak të deputetëve, përkundër avokimit të qëndrimeve individuale, pasi që deputetët të cilët i mbështesin të drejtat e LGBTI mund të gjenden nga radhët edhe të opozitës edhe të pushtetit, por në Parlament duhet të veprojnë sipas instruksioneve.

...ndryshimi i kulturës, qëndrimeve dhe mentalitetit të partive më të mëdha politike. Ata në njëfarë mënyre, për fat të mirë ose për fat të keq, lëvizës të shoqërisë, bile edhe për nga krijimi i opinionit për çështje të ndryshme. Kur në një parti politike do të ulet antagonizmi lidhur me këto çështje, dhe kur do të zvogëlohen nevojat që të fitohen pikë politike lidhur me këto çështje, atëherë do të jemi në nivel tjetër, dhe kjo do të rezultojë me rezultate pozitive edhe në raport me deputetët dhe Parlamentin dhe lidhur me gjithë shoqërinë.¹⁴

2. **Një pjesë e deputetëve shprehë vullnet t'i shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat që i kanë në dispozicion** me qellim të avancimit të drejtave të LGBTI, **ndërsa një pjesë shihen si mbështetje e deputetëve iniciatorë**, derisa disave u nevojiten më shumë informata ose do të inkuadroheshin në mënyrë më aktive dhe do të mbështesnin iniciativa varësisht nga tema, gjegjësisht **do të mbështesnin masa për avancimin e të drejtave qytetare siç janë diskriminimi dhe mbrojtja nga dhuna**. Deputetët rolin e tyre e shohin më shumë në intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat qytetare, mbështetje iniciativave ligjdhënëse, veçanërisht të LPMD, organizimi i diskutimit në komisione në bashkëpunim me organizatat qytetare, parashtimi i pyetjeve të deputetëve dhe marrja e fjalës në debate dhe diskutime. Në këtë pjesë deputeti nga opozita theksoi se Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarit nuk ka mbajtur mbledhje tetë vjet dhe se nevojiten përpjekje për revitalizimin e këtij Komisioni, ku kund të hapen edhe çështjet lidhur me LGBTI.

3. Deputetët mendojnë se **që të avokohen me sukses të drejtat e LGBTI njerëzve, do t'u ndihmonin aktivitete shtesë për zhvillimin e kapaciteteve të tyre**, si trajnime, përvoja nga vendet tjera, bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat qytetare dhe masat për ngritjen e vetëdijes publike.

14 Intervista nr. 9, deputet i LSDM.

4. PËRFUNDIM

Deputetët kanë në dispozicion mekanizma ligjore dhe të rregullores për punë që të avokohen në mënyrë aktive avancimi i të drejtave të LGBTI njerëzve. Në pajtim me analizën e programeve të partive politike dhe përpjekjet e tyre në periudhën parazgjedhore, shumica aktuale parlamentare ka vullnet politik në suaza të kompetencave të tyre të punojë në avancimin e të drejtave të LGBTI njerëzve.

Shumicën parlamentare e përbëjnë partitë politike nga qendra ose qendra-majtas, të cilët në mënyrë të prerë e mbështesin mbrojtjen nga diskriminimi, dhuna dhe gjuha e urrejtjes drejt LGBTI njerëzve. Mbështetje për këto çështje jep edhe shumica e deputetëve nga partitë politike shqiptare, duke përfshirë edhe BESA. VMRO-DPMNE dhe BESA janë parti opozitare me numër më të madh të deputetëve, ndërsa në të ardhmen mund të paraqiten si oponentë në avancimin e të drejtave të bashkësisë së LGBTI dhe gjatë kësaj mund ta shfrytëzojnë këtë çështje për vetë-promovim si mbrojtës të “vlerave familjare”.

Deputetët të cilët kanë marrë pjesë në këtë vlerësim disponojnë me njohuri të kufizuara ose të pjesshme për kornizën ekzistuese ligjore për mbrojtje nga dhuna dhe diskriminimi, por pjesa më e madhe nga deputetët e intervistuar tregojnë nivel të ulët të distancës sociale, gjegjësisht nuk ekziston nivel i lartë i paragjykimeve dhe stigmës. Shumica e deputetëve i njohin LGBTI njerëzit si viktima të diskriminimit dhe dhunës dhe mendojnë se duhet të avancohen gjendjet në shumë fusha, përmes avancimit të kornizës ligjore, por edhe përmes aktiviteteve për ndryshim të vetëdijes. Lidhur me të drejtat e njerëzve trans gjinor, deputetët disponojnë me shumë pak informata për nevojat dhe gjendjen, e me këtë edhe janë të përbajtur për mbështetje të ligjeve ose politikave konkrete në përgjigjen ndaj nevojave të njerëzve trans gjinor, bile edhe pse një pjesë e deputetëve shprehin gatishmëri të mbështesin ligj me të cilin do të sigurohet qasje e lehtë deri te njohja juridike e gjinisë. Edhe pse në numër më të vogël për dallim nga mbrojtja nga dhuna dhe diskriminimi, deputetët e mbështesin bashkësinë jashtë martesore dhe martesore mes çifteve me gjini të njëjtë, por jo edhe adoptimin e fëmijëve.

Në pajtim me përvojën e deritanishme të punës së Parlamentit, deputetët veprojnë në pajtim me qëndrimet dhe vendimet partiake, ndërsa diskutimet parlamentare për të drejtat e LGBTI njerëzve deri tanë kanë qenë shkas për gjuhën e urrejtjes dhe qërimin e hesapeve partiake me oponentët. Shumica e deputetëve të anketuar shprehën vullnet që në mënyrë aktive të angazhohen për avancimin e gjendjes me LGBTI njerëzit dhe gjatë kësaj t'i shfrytëzojnë mekanizmat parlamentare, por edhe pozitën e tyre shoqërore të deputetëve. Miratimi i Propozim-ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili e përmban orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza, shihen si hap i ardhshëm drejt avancimit të drejtave të LGBTI, për të cilët deputetët nga shumica parlamentare dhe BESA jepin mbështetje.

